

SPAR Albania është pjesë e Balfin Group dhe drejton rrjetin më të madh të shitjeve ushqimore me pakicë me të drejtën e ekskluzivitetit të emrit “SPAR”.

Grupi BALFIN është një nga grupet e investimeve lider në rajonin e Ballkanit Perëndimor që mishëron standardet ndërkombëtare me ekspertizë vendase. I themeluar në vitin 1993 në Vjenë nga Samir Mane, sot Grupi është i pranishëm në 11 vende, Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Zvicër, Kroaci, Holandë, SHBA dhe Kanada. BALFIN, një grup i larmishëm, aktiv në pasuri të paluajtshme, shitje me shumicë dhe pakicë, sistemin bankar, menaxhim asetesh, turizëm, arsim dhe logjistikë, punëson rreth 5000 njerëz. Totali i Aseteve të Grupit (përfshirë institucionin financiar) është 2.2 miliardë euro, sipas të dhënave të vitit 2023.

Pozicioni: Arkitekt/e.

Departamenti: Departamenti i Eksapansionit dhe Zhvillimit.

Vendodhja: Zyra Qëndrore, Tiranë.

Detyra dhe Përgjegjësi:

- Konsultimi me profesionistë të tjerë në lidhje me hartimin e nje projekti;
- Përgatitja dhe prezantimi i raporteve të vizibilitetit dhe propozime të projektimit për mbikëqyrësit;
- Mbajtja brenda buxheteve financiare dhe afatet;
- Prodhimi i punimeve të detajuara , vizatimet, preventivave dhe specifikimet;
- Të plotesoje me detaje, rifinitura, plotësime të ndryshme sipas rastit dhe të ndjeke zbatimin duke supervizuar dhe duke u kujdesur për zbatimin korrekt të projekteve dhe preventivave;
- Negocimi me kontraktorët dhe profesionistë të tjerë;
- Përgatitjen e aplikacioneve për planifikimin dhe departamentet e kontrollit të ndërtimit;
- Menaxhimi i projektit duke ndihmuar për të koordinuar punen e kontraktoreve;
- Kontrollimi i një projekti nga fillimi ne fund; vizita të rregullta për të kontrolluar zhvillimet, duke siguruar që projekti po konkurren në kohe dhe në buxhet;
- Zgjidhja e problemeve dhe çështjeve që lindin gjatë ndërtimit;
- Të sigurohet që ndikimi mjedisor i projektit është menaxhuar.

- Detyra të tjera të ngarkuara nga eprori referuar nevojave të departamentit.

Kërkesat:

a.Edukimi: Diplomë Universitare në financë, Profili Arkitekturë.

b.Eksperiencat e punës: Eksperiencë pune të ngjashme, preferohet mbi 3 vjet.

c.Kualifikime të tjera:

- Njohuri të shkëlqyera kompjuterike, të programit AutoCad, Sket up
- Eksperiencë pune në një mjedis dinamik dhe të shpejtë me ekspozim të konsiderueshëm ndaj riskut
- Njohuri shumë të mira të paketës Microsoft Office:

d.Aftësi të tjera:

- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikuese.
- Aftësi të shkëlqyera për planifikim dhe menaxhim të kohës.
- Të jetë i fokusuar te detajet.
- Proaktiv, i motivuar dhe entuziast.
- Aftësi të mira negociuese dhe bashkëpunuese me furnitorët për të krijuar marrëveshjet më të mira.
- Aftësi për manaxhimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme që mund të shfaqen.
- Aftësi shumë të mira për të punuar në grup.

Mënyra e aplikimit*: Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV e tyre në adresën e e-mailit hr@spar.al duke përcaktuar në subjekt pozicionin ose nëpërmjet postës në adresën: SPAR Tirana East Gate (TEG), Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, Farkë (Lundër), Tiranë, Shqipëri.

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr .9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.*